



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 644/₄ prot.

Tiranë më 27.07.2020

VENDIM

Nr. 26, datë 27.07.2020

PËR KONTROLLUESIN “LUFTHANSA INDUSTRY SOLUTIONS” SHPK

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77 - 112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Lufthansa Industry Solutions” SHPK,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 88, datë 05.06.2020 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye një hetim administrativ pranë kontrolluesit “Lufthansa Industry Solutions” SHPK (në vijim, “Kontrolluesi”), me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi “Lufthansa Industry Solutions” SHPK.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi, ushtron veprimtarinë në fushën e aktiviteteve të lidhura me dizenjimin, prodhimin dhe zhvillimin e software-ve, zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh, dizenjim dhe zhvillim sistemesh të sigurisë, migrimi dhe komunikimi, suport i përdorimit dhe auditimit teknik/informatik për aplikacionet/software, etj.
Në kuadër të marrëdhënies së punës kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave “punëmarrës, punonjës të larguar, kandidatë për punë dhe vizitorë”. Të dhënat personale përpunohen manualisht, si dhe nëpërmjet instrumenteve elektronike.

2. Kontrolluesi disponon në faqen zyrtare të Grupit "*Lufthansa Industry Solutions*", <https://www.lufthansa-industry-solutions.com/de-en/location-tirana/>, një rubrikë për Politikën e Privatësisë në gjuhën angleze dhe gjermane.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, meqenëse Kontrolluesi ushtron veprimtarinë e tij brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, informimi nëpërmjet Politikave të Privatësisë duhet të jetë edhe në gjuhën shqipe dhe të referojë të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni shqiptar, në përputhje me nenin 18 të Ligjit. Detyrimi për informim shtrihet përtej njohurive gjuhësore të subjekteve që aksesojnë faqen e internetit të Kontrolluesit. Mospërmbushja e këtij detyrimi, mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket jetës private dhe, bashkë me të, të drejtës së subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave personale të tyre.

3. Kontrolluesi disponon kontratë më shoqërinë e sigurimit "*Sigma InterAlbanian*", në lidhje me sigurimin shëndetësor të punonjësve dhe familjarëve të tyre.

Pika 4.5 e kësaj kontrate parashikon se rezultatet e kontrolleve dhe raportet mjekësore të trajtimeve do t'i dërgohen nëpërmjet postës elektronike mjekut të Kontrolluesit, në adresën personale (emër@gmail.com).

Diktuar nga parashikimet e kësaj kontrate, mjekut të shoqërisë i mundësohet në formatin elektronik një kopje e të dhënave shëndetësore të familjarëve të punonjësve.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se Kontrolluesi ka përpunuar jo vetëm të dhënat sensitive të punëmarrësve, por edhe ato të familjarëve të tyre. Vetëm pas konstatimit të këtij përpunimi nga ana e inspektorëve, Kontrolluesi i ka fshirë të dhënat në fjalë.

Pavarësisht fshirjes së të dhënave sensitive të familjarëve të Kontrolluesit, përpunimi i tyre i pa mbështetur në asnjë nga parashikimet e pikës 1 të nenit 6 të Ligjit, përbën përpunim të paligjshëm të dhënash personale.

Gjithashtu, në kontratën në fjalë nuk parashikohen detyrimet e palëve për përpunimin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*", i ndryshuar (në vijim Udhëzimi 19).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr. 19.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në Protokollin e Zyrës së Komisionerit, si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit.

Nga ana tjetër, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka kryer deklaram të saktë, sa i përket deklaramit në rubrikën 7, “*Marrësit e të dhënave personale*” drejt të cilëve Kontrolluesi përhap të dhënat në zbatim të detyrimeve ligjore, të tilla si banka, administrata tatimore dhe ato përgjegjëse për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim në mënyrë të plotë, duke specifikuar subjektet dhe institucionet publike ku përhapen këto të dhëna është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi, përfshirë përhapjen e të dhënave në kuadër të realizimit të detyrimeve ligjore dhe/ose kontraktore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale dhe efektive subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e Ligjit.

5. Në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë, Kontrolluesi ka instaluar një sistem video-survejimi (CCTV) të përbërë nga 6 kamera, konkretisht 1 në ambientin e receptionit, 4 kamera në korridore dhe 1 në dhomën e serverit.

Kontrolluesi nuk dispononte rregulla specifike në lidhje me përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV), në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit.

Këtë mungesë, Kontrolluesi e ka rregulluar pas nisjes së hetimit, duke paraqitur rregulloren e ndryshuar.

Gjithsesi, sërish vërehet se, në nenin 13 të rregullores “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, janë parashikuar dispozita përshkruese në lidhje me sistemin e video-survejimit, por këto dispozita nuk reflektojnë mbrojtjen nga akseset e paautorizuara apo aksidentale, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se siguria nuk ka të bëjë vetëm me marrjen e masave fizike, megjithëse këto janë shumë të rëndësishme, por edhe me dokumentimin e tyre duke reflektuar kujdesin e duhur në qartësinë e masave organizative dhe aksesueshmërinë e tyre nga subjektet e të dhënave (në rastin konkret, punonjës dhe/ose vizitorë).

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87 - 89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit është paraqitur në seancën dëgjimore të organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka paraqitur prova për të dokumentuar rikuperimin e disa prej shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij.

Ndonëse Zyra e Komisionerit vlerëson reflektimin e Kontrolluesit, kjo nuk e përjashton atë nga përgjegjësia administrative, pasi shkeljet e konstatuara janë kryer para daljes së urdhrimit të hetimit administrativ.

Më tej, në lidhje me kontratën e sigurimit të përshkruar në pikën 3 më sipër, Kontrolluesi është mjaftuar me pretendimin se në këtë kontratë ai nuk është kontrollues, por përpunues i të dhënave personale. Për këtë pretendim, Kontrolluesi nuk paraqiti asnjë argument ligjor që të përlligjte qasjen e tij në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e Ligjit.

Në lidhje me këtë pretendim, Zyra e Komisionerit gjen rastin të theksojë se mosnjohja nga Kontrolluesi dhe, rrjedhimisht, mosveprimi i tij në përputhje me cilësinë që i atribuohet me ligj (në këtë rast kontrollues dhe jo përpunues) përbën shkelje të hapur të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mungesë të theksuar serioziteti për të adresuar kërkesat e Ligjit, i cili, në themel të tij, ka garantimin mbrojtjes së të dhënave personale dhe jetës private të individëve, si një kategori të drejtash vetjake e parashikuar shprehimisht në nenin 35 të Kushtetutës.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ përbëjnë kundërvajtje administrative, në kuptim germave "a", "ç", "d" dhe "dh" të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, si dhe sanksionohen me gjobë si më poshtë:

- a) *kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- ç) *kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- d) *kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- dh) *kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;*

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 20, 21, 27, 29, 30, 39 (pika 1, germet "a", "ç", "d" dhe "dh"), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit me gjobë në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit;
2. Dënimin e kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 21 të Ligjit;
3. Kontrolluesi të ketë në vëmendje përditësimin e njoftimit, në rast të ndryshimit të gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale në përputhje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale në gjuhën shqipe, përmes publikimit të politikës së privatësisë në faqen e internetit;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të ligjit, të marrë masa për përditësimin e rregullave të brendshme në të cilat parashikohen masa konkrete teknike dhe organizative dhe të reflektojnë mbrojtjen nga aksesit i paautorizuar apo aksidental, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar i të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video-surveimit;
7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të ligjit, të përmbushet detyrimet e përcaktuara në pikat 5 dhe 6 më sipër, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni të këtij akti, si dhe të njoftojë Komisionerin për masat e marra.
8. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit.
9. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më 27.07.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

